



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË DIGJITALIZUAR PËR PUNËSIMIN SI TEKNIK I
SHKENCAVE MJEKËSORE**

Ju informojmë se gjatë muajit Dhjetor 2025, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: *Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH)*, do të zhvillohet provimi i digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.

Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Dokument identifikimi (Kartë identiteti ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
 - Faturën origjinale të pagesës së tarifës së provimit për llogari të QSHA-së.
- Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun:

https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/Fatura_provime.pdf

Kandidati gjatë zhvillimit të provimit, duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
- firmos procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Kalendari i organizimit të provimit dhe orari i pjesëmarrjes në provim për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al. Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Për çdo pasaktësi lidhur me të dhënat në listat që do të publikohen në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, lutemi t’i drejtoheni Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ju urojmë Suksese!